

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 SPORTIT DHE RINISË  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019**  
**ME ZGJEDHJE**

**Lënda: Ekonomi****Model Testi**

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **60 pikë**.Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim**.Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2. ....Anëtar

1. Mjetet e prodhimit në ekonominë e komanduar i zotëron:

1 pikë

- A) konsumatori;
- B) biznesi;
- C) qeveria;
- D) familja.

2. Jepet tabela e mëposhtme, e cila tregon mundësitë që ka një vend për të prodhuar:

3 pikë

Kombinimet e mundshme	Tekstile	Ushqime
A	30	0
B	20	15
C	15	18
D	5	24
E	0	35

a) Sa është zgjedhja kur kalojmë nga kombinimi A në kombinimin B?

---

b) Sa është kosto oportune kur kalojmë nga kombinimi A në kombinimin B?

---

c) Çfarë prijje vihet re për prodhimin e tekstileve?

---

3. Fakti që molla ka portokallin një zëvendësues të afërt në konsum, e bën:

1 pikë

- A) ofertën për mollë më elastike;
- B) ofertën për mollë më pak elastike;
- C) kërkesën për mollë më elastike;
- D) kërkesën për mollë më pak elastike.

4. Në qoftë se një mall e ka kërkesën elastike, atëherë:

1 pikë

- A) një rritje 1% në çmimin e mallit shkakton një rritje më pak se 1% në sasinë e kërkuar;
- B) një rritje 1% në çmimin e mallit shkakton një rritje më shumë se 1% në sasinë e kërkuar;
- C) një rritje 1% në çmimin e mallit shkakton një rënie më shumë se 1% në sasinë e kërkuar;
- D) një rritje 1% në çmimin e mallit shkakton një rënie më pak se 1% në sasinë e kërkuar.

5. Kur qeveria vendos një çmim dysheme për një mall të caktuar, atëherë sasia e ofruar:

1 pikë

- A) do të jetë më e vogël se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i vogël se çmimi i ekuilibrit;
- B) do të jetë më e vogël se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i lartë se çmimi i ekuilibrit;
- C) do të jetë më e madhe se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i vogël se çmimi i ekuilibrit;
- D) do të jetë më e madhe se sasia e ekuilibrit, ndërsa çmimi do të jetë më i lartë se çmimi i ekuilibrit.

6. Tragetit i linjës Durrës–Bari ka gjithsej 2 000 vende. Kërkesa për udhëtim nga pushuesit në muajin gusht dhe çmimi jepen në tabelën e mëposhtme.

3 pikë

P (Çmimi)	1 000	2 500	4 000	6 500	8 000	10 000
Q <sub>D</sub> (Sasia e kërkuar)	3 500	2 800	2 500	2 000	1 200	500

Nëse faktorët e tjerë mbeten të pandryshuar:

- a) gjeni sa është çmimi ekuilibër.

---

- b) tregoni një çmim në rastet kur kemi tepërisë kërkesë.

---

- c) gjeni sa vende bosh ngelen për çmimin 10 000 njësi paraje.

---



---

7. Nëse malli A dhe B janë plotësues të njëri-tjetrit në konsum, ulja e çmimit të mallit A do të sjellë:

1 pikë

- A) zhvendosjen në të djathtë të lakores së ofertës për mallin B;  
 B) zhvendosjen në të djathtë të lakores së kërkesës për mallin B;  
 C) zhvendosjen në të majtë të lakores së ofertës për mallin B;  
 D) zhvendosjen në të majtë të lakores së kërkesës për mallin B.

8. Nëse në një treg konkurrenës, sasia e ofruar është më e madhe se sasia e kërkuar, atëherë:

1 pikë

- A) çmimi i tregut do të ulët;  
 B) çmimi i tregut do të rritet;  
 C) konsumatorët do të kërkojnë më shumë produkte;  
 D) ofruesit do të ulin sasinë e produkteve të ofruara në treg.

9. Në një treg të veshjeve sportive, çmimi ka ndryshuar nga 5 në 10 lekë dhe sasia ka ndryshuar nga 20 në 80 copë. Tregoni:

4 pikë

- a) për çfarë elasticiteti bëhet fjalë?

---

- b) sa është elasticiteti i përlogarit me metodën e pikës së mesit?

---



---

- c) Çfarë tregon koeficienti i llogarit në kërkesën b?

---

- d) Bëni paraqitjen grafike të këtij elasticiteti.

10. Alba është nxënëse në shkollë të mesme. Familja e saj përbëhet nga tri persona. Mamaja e saj është punonjëse në një bankë tregtare me një pagë prej 95 000 lekë në muaj. Babai është inxhinier dhe merr një pagë prej 120 000 lekë në muaj. Ata zotërojnë një apartament me vlerë 5 milion lekë, një dyqan me vlerë 8 milion lekë, që e japin me qira 45 000 lekë në muaj, dhe një depozitë kursimi 12 mujore, me një shumë prej 600 000 lekë dhe me një vlerë të interesit mujor 3 000 lekë.

**3 pikë**

a) Sa janë të ardhurat mujore nga puna në familjen e Albës?

---

---

b) Sa janë të ardhurat mujore nga pasuria në familjen e Albës?

---

---

c) Sa është vlera totale e pasurisë që zotëron familja e Albës?

---

---

11. Duke patur parasysh bilancin e firmës ne mund të llogarisim:

**1 pikë**

- A) vlerën neto;
- B) fitimin e firmës;
- C) të ardhurat e firmës;
- D) kostot e firmës.

12. Një aksioner shet aksionet e tij. Shpjegoni kur ai mund të dalë:

**3 pikë**

a) me fitim.

---

---

b) me humbje.

---

---

c) as me fitim as me humbje.

---

---

13. Jepni dy arsye pse njerëzit duan të kenë biznesin e tyre.

**2 pikë**

- ---

---
- ---

---

14. Sasia maksimale e produktit që do të prodhojë firma, nga bashkërendimi i faktorëve të prodhimit quhet: **1 pikë**

- A) funksioni i ofertës;
- B) funksioni i kërkesës;
- C) funksioni i prodhimit;
- D) funksioni i këmbimit.

15. Tabela e mëposhtme tregon funksionin e prodhimit të një firme që vepron në periudhë afatshkurtër. Nëse puna është faktor i ndryshueshëm dhe kapitali faktor i fiksuar, pas cilit punëtor fillon të veprojë ligji i të ardhurave marxhinale rënëse?

**1 pikë**

L	0	1	2	3	4	5	6	7
TPP	0	10	22	35	43	50	50	48

- A) Pas punëtorit të parë;
- B) Pas punëtorit të dytë;
- C) Pas punëtorit të tretë;
- D) Pas punëtorit të katërt.

16. Situata e mëposhtme i referohet ecurisë së një firme në treg.

**3 pikë**

Çmimi P	Produkti total TPP	Kostoja mesatare fikse AFC	Kostoja mesatare e ndryshueshme AVC
24 lekë	240 copë	10 lekë	12 lekë

Duke analizuar treguesit ekonomikë të kësaj firme në treg, gjeni:

a) sa janë shpenzimet totale të kësaj firme?

---



---

b) sa është fitimi apo humbja që realizon firma?

---



---

c) sa është kostoja totale kur niveli i prodhimit është zero, duke ditur që jemi në periudhë afatshkurtër?

---



---

17. Cila nga situatat e mëposhtme ndodhet në pozita monopol në tregun shqiptar?

**1 pikë**

- A) Shitësit e veshjeve sportive në Durrës;
- B) Firmat që shesin karburant në autostradën Tiranë-Durrës;
- C) Disa firma të mëdha për përpunimin e mishit në Tiranë;
- D) E drejta e shënpisë botuese Onufri për të botuar veprat e Kadaresë.

18. Duke krahasuar konkurrencën monopolistike dhe oligopolin, identifikoni:

3 pikë

a) dy tipare të përbashkëta.

---



---



---

b) një dallim.

---



---



---

19. Supozojmë se jemi në tregun e faktorëve të prodhimit. Lakorja e ofertës për tokë në periudhat afatshkurtra është plotësisht joelastike, ndërsa çmimi i misrit në treg ulet. Çfarë do të ndodhë në tregun e tokës?

1 pikë

- A) Renta do të ulej dhe sasia e ekuilibrit të tokës do të ulej;
- B) Renta do të rritej dhe sasia e ekuilibrit të tokës do të rritej;
- C) Renta do të rritej, ndërsa sasia e ekuilibrit të tokës do të mbetet e pa ndryshuar;
- D) Renta do të ulej, ndërsa sasia e ekuilibrit të tokës do të mbetet e pa ndryshuar.

20. Cila nga alternativat e mëposhtme paraqet një mundësi për uljen e defiçitit buxhetor?

1 pikë

- A) Qeveria rit shpenzimet qeveritare;
- B) Qeveria blen pajisje për ushtrinë;
- C) Qeveria merr hua nga publiku;
- D) Qeveria kontrollon shpenzimet.

21. Shpenzimet kapitale janë:

1 pikë

- A) shpenzimet e qeverisë për mbrojtje sociale;
- B) shpenzimet operative për mirëmbajtje;
- C) shpenzimet për ndërtimin e rrugëve;
- D) shpenzimet për kompensimin e pronarëve.

22. Listoni tri arsye pse zhvillimi arsimor nuk duhet lënë tërësisht në sektorin privat.

3 pikë

- ---
- ---
- ---

**23.** Banka Qendrore harton, miraton dhe zbaton politikën monetare duke kontrolluar ofertën e parasë. Në këtë mënyrë ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi. Në cilët tregues ekonomik ndikon ajo? **3 pikë**

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**24.** Kategoritë e njerëzve që përfitojnë nga inflacioni janë: **1 pikë**

- A) njerëzit me të ardhura fikse;
- B) kursyesit;
- C) huadhënësit;
- D) huamarrësit.

**25.** Tregoni cili nga shembujt e mëposhtëm përfshihet dhe cili nuk përfshihet në GDP? **3 pikë**

a) Reçeli i përgatitur nga nëna në shtëpi, që ua dha miqve të saj.

\_\_\_\_\_

b) Vlera e ndotjes së mjedisit që sjell prodhimi i çimentos nga firma.

\_\_\_\_\_

c) Prodhimi i zarzavateve në kopshtin e shtëpisë që shiten në treg.

\_\_\_\_\_

**26.** Fazat e një cikli biznesi janë të renditura si më poshtë: **1 pikë**

- A) recensionin, pika më e ulët, piku, ekspansioni;
- B) pika më e lartë, recensionin, pika më e ulët, ekspansioni;
- C) recensionin, piku, ekspansionin, pika më e ulët;
- D) ekspansionin, recensionin, piku, pika më e ulët.

**27.** Për çfarë papunësie bëhet fjalë në situatat e mëposhtme? **2 pikë**

a) Një person mbaron shkollën për ekonomi financë, por vende pune për financier nuk ka. Ndërkohë ofrohen vende pune si arkëtar në një bankë, por ai nuk pranon të punojë si arkëtar.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) Viola la punën aktuale dhe synon një punë tjetër, e cila i përshtatet dëshirave të saj për të ecur në karrierë.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- 28.** Politikat që ndikojnë mbi normat e interesit dhe sasinë e parave në qarkullim quhen: **1 pikë**
- A) fiskale;  
B) monetare;  
C) valutore;  
D) doganore.
- 29.** Supozojmë se Banka Qendrore rrit normën e interesit me skonto të huave që ajo u jep bankave të nivelit të dytë. **2 pikë**
- a) Çfarë do të ndodhë me ofertën monetare në këtë rast?  
\_\_\_\_\_
- b) Në cilën fazë të cikleve të biznesit e rrit Banka Qendrore normën e skontos?  
\_\_\_\_\_
- 30.** Tregtia midis vendeve bazohet në përparësinë: **1 pikë**
- A) objektive;  
B) krahasuese;  
C) analitike;  
D) teknologjike.
- 31.** Listoni tri qëllime të një kodi etike. **3 pikë**
- \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
  - \_\_\_\_\_
- 32.** Një individ do të preferojë të hapë një depozitë kursimi pa afat, atëherë kur: **1 pikë**
- A) ai do të marrë një normë të lartë interesi nga depozita e tij;  
B) ai ka më shumë para të kursyera gjatë një viti;  
C) atij do t'i nevojitej të tërhiqte paratë në çdo kohë;  
D) ai nuk do t'ia dijë se çfarë do të ndodhë me depozitat e tij.
- 33.** Keni një shumë të caktuar parash. Kërkoni për to siguri dhe të përfitoni sa më shumë para prej tyre. Zgjedhja më e mirë e mundshme do të ishte: **1 pikë**
- A) një llogari e thjeshtë kursimi me normë interesi në masën 2%;  
B) bono thesari me afat maturimi tre mujor me normë interesi 6%;  
C) depozita kursimi afatgjata me normë interesi 4%;  
D) obligacione të korporatës me normë interesi 8%.
- 34.** Një person i cili fillon një biznes për të prodhuar një produkt të ri njihet si: **1 pikë**
- A) manaxher;  
B) sipërmarrës;  
C) drejtues firme;  
D) nëpunës.